Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 4.00% për periudhën raportuese janar – shtator 2024 (ndërsa për janar – dhjetor 2023, 3.85%).

Ndërsa, si zëra jashtë bilancor (zotime ndaj FMN-se) BQK ka kjo shumë e këtyre zotimeve me 30 Shtator 2024 është 65.7 milion euro (në periudhën krahasuese kjo vlerë ka qenë 75.4 milion euro). Të rrjedha nga shfrytëzimi i fondeve të qeverisë së Kosovës nga FMN.

10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme**Mjetet e prekshme përbëhen si më poshtë:**

| Kosto | Investime në objekte | Pajisje | Kompjuter | Automjete | Aktivët në proces | Gjithsej |
|---------------------------------------|-----------------------------|---------------------|---------------------|-------------------|--------------------------|----------------------|
| Më 01 Janar 2023 | 6,113,235.74 | 2,528,258.52 | 1,910,664.49 | 389,349.16 | 3,680.00 | 10,945,187.91 |
| Blerje | 8,969.00 | 243,112.66 | 377,780.64 | - | 1,940.00 | 631,802.30 |
| Transfere (nga)/në (korrigjim) | - | - | - | - | - | - |
| Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje) | - | (6,123.00) | (5,797.85) | - | - | (11,920.85) |
| Më 31 Dhjetor 2023 | 6,122,204.74 | 2,765,248.18 | 2,282,647.28 | 389,349.16 | 5,620.00 | 11,565,069.36 |
| Më 01 Janar 2024 | 6,122,204.74 | 2,765,248.18 | 2,282,647.28 | 389,349.16 | 5,620.00 | 11,565,069.36 |
| Blerje | 21,583.00 | 112,689.29 | 155,899.73 | - | 1,200.00 | 291,372.02 |
| Transfere (nga)/në (korrigjim) | - | - | - | - | - | - |
| Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje) | - | (12,399.01) | (6,073.95) | - | - | (18,472.96) |
| Më 30 Shtator 2024 | 6,143,787.74 | 2,865,538.46 | 2,432,473.06 | 389,349.16 | 6,820.00 | 11,837,968.42 |
| Zhvlerësimi | | | | | | |
| Më 01 Janar 2023 | 2,297,661.00 | 2,344,203.84 | 1,738,268.35 | 366,282.53 | - | 6,746,415.72 |
| Zhvlerësimi i vitit | 310,505.05 | 97,338.32 | 126,243.58 | 13,840.00 | - | 547,926.95 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje) | - | - | (5,016.66) | - | - | (5,016.66) |
| Më 31 Dhjetor 2023 | 2,608,166.05 | 2,441,542.16 | 1,859,495.27 | 380,122.53 | - | 7,289,326.01 |
| Më 01 Janar 2024 | 2,608,166.05 | 2,441,542.16 | 1,859,495.27 | 380,122.53 | - | 7,289,326.01 |
| Zhvlerësimi i vitit | 232,632.24 | 84,010.85 | 123,333.68 | 9,226.63 | - | 449,203.40 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje) | - | - | (5,065.04) | - | - | (5,065.04) |
| Më 30 Shtator 2024 | 2,840,798.29 | 2,525,553.01 | 1,977,763.91 | 389,349.16 | - | 7,733,464.37 |
| Neto vlera e bartur | | | | | | |
| Më 01 Janar 2023 | 3,815,574.74 | 184,054.68 | 172,396.14 | 23,066.63 | 3,680.00 | 4,198,772.19 |
| Më 31 Dhjetor 2023 | 3,514,038.69 | 323,706.02 | 423,152.01 | 9,226.63 | 5,620.00 | 4,275,739.08 |
| Më 30 Shtator 2024 | 3,302,989.45 | 339,985.45 | 454,709.15 | - | 6,820.00 | 4,104,499.91 |

10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme (vazhdim)**Mjetet e paprekshme përbëhen si më poshtë:**

| Kosto | Programe kompjuterike | Programe kompjuterike në proces | Gjithsej |
|---------------------------------------|------------------------------|--|---------------------|
| 01 Janar 2023 | 3,186,844.78 | - | 3,186,844.78 |
| Blerje | 139,365.86 | - | 139,365.86 |
| Transfere (nga)/në (korrigjim) | - | - | - |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | - | - | - |
| 31 Dhjetor 2023 | 3,326,210.64 | - | 3,326,210.64 |
| 01 Janar 2024 | 3,326,210.64 | - | 3,326,210.64 |
| Blerje | 107,522.88 | - | 107,522.88 |
| Transfere (nga)/në (korrigjim) | - | - | - |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | - | - | - |
| Më 30 Shtator 2024 | 3,433,733.52 | - | 3,433,733.52 |
| Amortizimi | | | |
| 01 Janar 2023 | 2,144,320.68 | - | 2,144,320.68 |
| Amortizimi për vitin | 285,570.85 | - | 285,570.85 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje) | - | - | - |
| Më 31 Dhjetor 2023 | 2,429,891.53 | - | 2,429,891.53 |
| Më 01 janar 2024 | 2,429,891.53 | - | 2,429,891.53 |
| Amortizimi për vitin | 189,697.09 | - | 189,697.09 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje) | - | - | - |
| Më 30 Shtator 2024 | 2,619,588.62 | - | 2,619,588.62 |
| Neto vlera e bartur | | | |
| Më 01 Janar 2023 | 1,042,524.10 | - | 1,042,524.10 |
| Më 31 Dhjetor 2023 | 896,319.11 | - | 896,319.28 |
| Më 30 Shtator 2024 | 814,144.90 | - | 814,144.90 |

12. Mjetet tjera

| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|--------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Llogarit e arkëtueshme | 2,205,734.50 | 2,325,158.41 |
| Parapagime | 291,384.74 | 150,423.49 |
| Pagesa/Kërkesa në proces (SNP/DepoX) | 849.48 | - |
| Gjithsej | 2,497,968.72 | 2,475,581.90 |

Kërkesat në proces (ATS) do të shlyhen pasi sistemi të ekzekuton pagesat në ditën e tretë të ardhshme të punës.

13. Detyrimet ndaj bankave në vend

| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|-------------------------------------|------------------------|------------------------|
| ProCredit Bank | 80,987,547.42 | 57,933,006.82 |
| Raiffeisen Bank | 83,451,386.57 | 74,171,335.72 |
| NLB Prishtina | 112,193,739.74 | 101,149,058.49 |
| Banka Ekonomike | 38,330,502.41 | 74,377,642.89 |
| Banka për Biznes | 32,151,469.32 | 54,243,862.01 |
| Banka Kombëtare Tregtare | 78,777,893.29 | 107,318,400.93 |
| Turk Ekonomi Bankasi Sh.A. | 66,861,848.29 | 68,284,335.55 |
| Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë | - | 7,482,389.22 |
| Turkiye Is Bankasi A.S. | 6,118,743.85 | 8,016,387.33 |
| T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosovë | 11,375,866.97 | 21,409,848.44 |
| Banka Kreditore e Prishtinës | 160,399.89 | 43,908.36 |
| Banka Credins Kosovë | 3,318,022.52 | 2,837,812.07 |
| PriBank Sh.A. | 12,459,510.51 | 13,239,325.81 |
| Gjithsej (pa interes akrual) | 526,186,930.78 | 590,505,379.88 |
| Interesi akrual | 121,317.37 | 116,692.73 |
| Transaksion në proces ndaj bankave | 884.88 | - |
| Gjithsej | 526,309,133.03 | 590,622,072.61 |

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave të nivelit të dytë që operojnë në vend (Kosovë). Dhe të cilat në BQK mbajnë mjetet sipas rregullativës ligjore për rezervën e likuiditetit.

Në total shuma e shpalosur më lart për periudhën raportuese 30 shtator 2024 është rreth 1.92 herë më e lartë se sa vlera e rezervës së obliguar që kërkohet të mbahet në BQK (ndërsa ky raport më 31 dhjetor 2023 po ashtu 2.35 herë).

Nga 1 janari 2023, BQK-ja aplikon normë pozitive 0.15% (vjetore) ndërsa nga 1 gusht 2023 aplikon normë 0.30% për të gjithë depozituesit e BQK-së.

Të njëjtën normë e aplikon në saldot e bankave komerciale në BQK deri në nivelin rezervën minimale të detyrueshme. Për bankat që kanë saldo mbi nivelin e rezervës minimale të detyrueshme, interesi do të aplikohen deri në vlerën e rezervës minimale të detyrueshme në nivel të bankës.

14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|---|------------------------|------------------------|
| Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2 | 65,434.43 | 5,566.53 |
| Pjesa e paguar e Kuotës te FMN-ja (nga qeveria) | 19,687,639.39 | 19,117,864.99 |
| Alokime nga FMN-ja në formë të DST | 162,988,572.11 | 163,801,988.95 |
| Kamata akruale | 1,167,496.93 | 1,291,570.59 |
| Gjithsej | 183,909,142.86 | 184,216,991.06 |

Zërat më lart paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-në që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN. Llogari nr.2 me FMN është llogari operative.

Pjesa e paguar e kuotës (paguar nga qeveria e Kosovës), si dhe ka të përfshirë edhe interesin e paguar nga IMF për këtë zë, sipas rregullativës së FMN-së, e cila në tabelë nën shënimin 14 është e shprehur në euro.

Alokimet në formë të Drejtave Speciale të Tërheqjes (DST/SDR) në FMN, përbëhen nga alokimet e përmendura në shënimin 9 më 28 gusht dhe 9 shtator 2009, si dhe shpërndarja (emetimi/alokimi) në vitin 2021.

Norma e interesit për zërin e alokimeve për periudhën raportuese dhe krahasuese është e njëjtë sikurse tek depozitat DST (SDR).

Në muajin maj 2023 FMN ka aprovuar edhe dy lloje të reja të financimit në emër të Kosovës një Linje kreditore dhe Instrumentin për qëndrueshmëri dhe stabilitet (buxhetor). Të dy këta instrument financiarë janë aktivë nga 25 maj 2023. Po ashtu ka një instrument tjetër aktiv nga viti 2020.

Saldo e tërhequr e mjeteve nga këta instrumentet financiar me 30 shtator 2024 është 65.7 milion euro, ndërsa me 31 Dhjetor 2023 ka qenë 75.4 milion euro, ndryshimi rrjedh nga tërheqja e re me 04 qershor 2024, pagesat e kësteve dhe lëvizja/ndryshimet e kursit të këmbimit EUR/SDR).

15. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|---|-----------------------|-----------------------|
| Llogarit rrjedhëse | | |
| Thesari – Ministria e Financave | 361,570,615.86 | 345,232,251.49 |
| Agjencia Kosovare për Privatizim | 172,333,105.46 | 166,373,337.05 |
| Institucionet e Përkohshme Administrative | 72,541.05 | 99,829.15 |
| Gjithsej llogarit rrjedhëse | 533,976,262.37 | 511,705,417.69 |
| Interesi akrual në llogari rrjedhëse | | |
| Thesari – Ministria e Financave | 86,673.82 | 155,221.79 |
| Agjencia Kosovare për Privatizim | 42,981.43 | 42,790.98 |
| Institucionet e Përkohshme Administrative | 18.30 | 25.79 |
| Gjithsej interesi akrual | 129,673.55 | 198,038.56 |
| Depozitat afatshkurtra | | |
| Thesari – Ministria e Financave | 300,979,042.23 | - |
| Agjencia Kosovare për Privatizim | - | - |
| Institucionet e Përkohshme Administrative | - | - |
| Gjithsej depozitat afatshkurtra | 300,979,042.23 | - |
| Gjithsej | 835,084,978.15 | 511,903,456.25 |

Depozitat në llogari rrjedhëse nga 1 gusht 2023 përfitojnë interes prej 0.30%, ndërsa nga 1 janar 2023 kanë përfituar interes prej 0.15%.

Afatizime aktive në periudhën raportuese ka vetëm nga llogaritë e qeverisë (vlera e shpalosur në tabelë), ndërsa edhe më 31 dhjetor 2023 nuk ka pasur afatizime aktive. Ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit operativë të institucioneve që përbëjnë grupin.

16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura në vijim:

| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|---|-----------------------|-----------------------|
| Kompanitë e sigurimeve | 4,160,787.37 | 4,151,783.27 |
| Institucione dhe kompani publike | 100,218,612.62 | 236,009,059.11 |
| Fondet e pensioneve jopublike dhe tjera | 1,721.42 | 1,733.31 |
| Gjithsej llogarit rrjedhëse | 104,381,121.41 | 240,162,575.69 |
| Interesi akrual në llogari rrjedhëse | | |
| Kompanitë e sigurimeve | 1,040.24 | 1,072.61 |
| Institucione dhe kompani publike | 26,355.52 | 38,065.84 |
| Fondet e pensioneve jopublike dhe tjera | 0.44 | 0.47 |
| Gjithsej interesi akrual | 27,396.20 | 39,138.92 |
| Gjithsej | 104,408,517.61 | 240,201,714.61 |

Institucionet dhe kompani publike përbëhen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, llogaritë nga Fondi i Sigurimeve të Depozitave dhe llogaritë në mirëbesim të KEK (Korporatës Energjetike të Kosovës), si përbërës më me peshë. Depozitat në llogari rrjedhëse nga 1 gusht 2023 përfitojnë interes prej 0.30%, ndërsa nga 1 janar 2023 kanë përfituar interes prej 0.15%.

17. Detyrimet nga Huamarrja/et

| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|------------------------------|---------------------|---------------------|
| Huamarrje nga Banka Botërore | 1,543,177.10 | 1,661,655.62 |
| Gjithsej | 1,543,177.10 | 1,661,655.62 |

Kemi dy projekte që janë financuar nga Banka Botërore përmes kredisë: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale (RTGS)*. Projekte këto të implementuara në vitin 2016. Kthimi i mjeteve është me afat mbi 10 vjet. Ndryshimi rrjedhë si rezultat i pagesave të kryegjësë dhe konvertimit të vlerës DST (SDR) në EUR në datë e raportimit.

18. Detyrime tjera

| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|--|---------------------|---------------------|
| Llogari në përkujdesje | 759,401.65 | 757,669.88 |
| Të hyrat e shtyra | 85,762.51 | 111,453.44 |
| Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale | 943,966.17 | 7,693,795.58 |
| Përfitimet afatgjata për punonjësit | 658,644.08 | 658,644.08 |
| Gjithsej llogarit rrjedhëse | 2,447,774.41 | 9,221,562.98 |

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim në gjithsej saldon e grupit krahasuar më 31 dhjetor 2023. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldo të llogarive të pagueshme dhe të hyrave të shtyra më 30 shtator 2024, krahas asaj më 31 dhjetor 2023.

19, 20 Kapitali i autorizuar dhe Rezervat**Kapitali dhe Rezervat e Përgjithshme**

| | 30 Shtator 2023 | 31 Dhjetor 2023 |
|----------------------------|-----------------------|----------------------|
| Kapitali i autorizuar | 30,000,000.00 | 30,000,000.00 |
| Fondet rezervë | 58,780,315.47 | 41,525,187.85 |
| Rezultati neto i periudhës | 23,370,799.21 | 27,631,114.66 |
| Gjithsej | 112,151,114.68 | 99,156,302.51 |

Rezultati financiar i periudhës është pozitiv për rreth 23.4 milionë euro, i ndikuar kryesisht nga realizimi i kënaqshëm i të hyrave dhe mbajtja e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor për periudhën raportuese.

Zëri i rivlerësimit valutator në datën e raportimit është në vlerë prej rreth 65.5 mijë euro (si humbje e porealizuar), zëri i provizioneve për humbjet e pritura kreditore (neto rritja/(zvogëlimi)) është në vlerë rreth 123 mijë euro (si humbje e porealizuar) dhe nëse i përjashtojmë këta dy zëra rezultati financiar mbetet pozitiv prej rreth 23.6 milionë euro (shiko faqe 6 - *Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit dhe të provizioneve*).

Sipas nenit 56, paragrafi 1.1. të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore. Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

| Të ardhurat e ndashme | | |
|--|-------------------------|-------------------------|
| Përshkrimi | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
| Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin | 23,370,799.21 | 27,631,114.66 |
| Nga të cilat janë fitimet (fitimet) e porealizuara nga rivlerësimi | - | - |
| Nga të cilat janë humbjet e porealizuara të rivlerësimit të cilat janë realizuar në vitin aktual | - | - |
| Të ardhurat e ndashme | 23,370,799.21 | 27,631,114.66 |
| Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme | | |
| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
| Kapitali | 30,000,000.00 | 30,000,000.00 |
| Rezervat e përgjithshme | 58,780,315.47 | 39,506,755.59 |
| Të ardhurat e ndashme | 23,370,799.21 | 27,813,382.17 |
| Gjithsej Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme | 112,151,114.68 | 97,137,870.25 |
| Gjithsej detyrimet monetare | | |
| | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
| Ndaj bankave komerciale vendore | 526,309,133.03 | 590,622,072.61 |
| Ndaj institucioneve qeveritare | 835,084,978.15 | 511,903,456.25 |
| Ndaj llogarive të lidhura me FMN ² | 182,741,645.93 | 1,291,570.59 |
| Ndaj institucioneve publike dhe komerciale | 104,408,517.61 | 182,925,420.47 |
| Nga huamarrja/et | 1,543,177.10 | 1,661,655.62 |
| Ndaj detyrimeve tjera monetare | 759,211.85 | 757,474.20 |
| Gjithsej detyrimet monetare | 1,650,846,663.67 | 1,528,071,793.76 |
| Raporti sipas nenit 56, paragrafi 1.1. | 6.79% | 6.36% |

21. Të hyrat neto nga interesi

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|---|------------------------|------------------------|
| Të hyrat nga interesi | | |
| Prej depozitave në llogarinë rrjedhëse | 10,051,665.91 | 7,171,823.80 |
| Prej afatizimeve në plasmanë | 10,169,149.18 | 4,524,634.20 |
| Prej letrave me vlerë | 8,903,865.61 | 7,184,799.55 |
| Prej depozitave me llogaritë me FMN (DST/SDR në posedim) | 4,580,751.07 | 4,300,596.26 |
| | 33,705,431.77 | 23,181,853.81 |
| Shpenzimet e interesit | | |
| Ndaj bankave rezidente në llogarinë rrjedhëse | 1,069,935.28 | 613,763.07 |
| Ndaj institucioneve qeveritare në llogarinë rrjedhëse | 1,172,781.03 | 1,091,671.93 |
| Ndaj institucioneve publike dhe komerciale në llogarinë rrjedhëse | 308,262.04 | 240,470.55 |
| Tjera në llogarinë rrjedhëse | 1,731.77 | - |
| Ndaj Thesarit-Ministria e Financave në depozita afatshkurtra | 5,753,750.89 | - |
| Ndaj llogarive me FMN (DST/SDR të alokuar) | 4,958,009.31 | 4,579,750.83 |
| Nga huazimi/et | 9,205.98 | 11,027.92 |
| | 13,273,676.30 | 6,536,684.30 |
| Të hyrat neto nga interesi | 20,431,755.47 | 16,645,169.51 |

² Përfshijë llogarinë e letrave me vlerë dhe akrualet.

Ashtu si edhe vërehet nga tabela nën shënimin 21, të hyrat nga interesi janë realizuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo ka ndikuar që neto të hyrat nga interesi janë më të larta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Norma mesatare e interesit për neto të hyrat nga interesi (duke marrë në konsideratë vetëm portfolion e angazhuar) për periudhën raportuese është rreth 1.883% (në periudhën e njëjtë të vitit 2023 ka qenë rreth 1.606%).

22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|--|---------------------|---------------------|
| Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat | | |
| Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme | 1,153,580.50 | 1,064,612.50 |
| Nga transferet hyrëse | 85,902.00 | 60,923.61 |
| Nga transferet dalëse | 471,190.00 | 331,413.36 |
| Nga transferet vendore (Sistemi i pagesave vendore) | 1,550,421.85 | 1,324,285.11 |
| Nga sistemi i regjistrimit të kredive | 177,720.20 | 161,306.60 |
| Të hyra nga tarifa tjera | 14,058.00 | 13,529.00 |
| | 3,452,872.55 | 2,956,070.18 |
| Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat | | |
| Prej qarkullimit të parasë së gatshme | 852,765.18 | 841,532.54 |
| Nga transaksionet me banka korrespondente | 38,135.21 | 38,769.83 |
| | 890,900.39 | 880,302.37 |
| Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat | 2,561,972.16 | 2,075,767.81 |

22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime (vazhdim)

Vërehet një rritje në neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kjo është nga rrjedha normale e aktivitetit për zërat e shpalosur në kuadër të grupit (ndryshim në volum veçanërisht të *aktiviteti i qarkullimit të parasë së gatshme, transferet dalëse (ndërkombëtare)* si dhe *transferet vendore*).

23. Të hyrat nga aktiviteti rregullator

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|--|---------------------|---------------------|
| Nga mirëmbajtja e licencave të bankave | 3,996,523.79 | 3,665,481.16 |
| Nga licencat prej institucioneve bankare | 61,300.00 | 74,600.00 |
| Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive të sigurimeve | 1,755,246.75 | 1,517,751.83 |
| Nga licencat prej kompanive të sigurimeve | 73,500.00 | 41,300.00 |
| Të hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale | 20,722.64 | 20,078.54 |
| Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jobankare) | 246,906.19 | 250,904.46 |
| Gjithsej | 6,154,199.37 | 5,570,115.99 |

Ndryshimi si rritje kryesisht është i mbështetur në rritjen e bazës (bazës përlllogaritëse/volumit të aktivitetit) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

24. Të hyrat nga grantet

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|-----------------------------|------------------------|------------------------|
| Të hyrat nga grantet | 26,320.93 | 30,837.39 |

Granti për sistemin e mbikëqyrjes financiare, është granti i vetëm aktive (në të hyra) për periudhën janar- qershor 2024. Ndërsa, presim rimburesime edhe nga Granti me BQE (ECB) për trajnimet e realizuara përmes atij projekti.

25. Të hyrat tjera operative

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|----------------------|------------------------|------------------------|
| Të hyra tjera | 10,148.40 | 13,630.31 |

Ky grup përbëhet nga të hyra prej aktiviteteve jo të zakonshme të BQK-së dhe të cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifikë të të hyrave. P.sh. shitja e tokenëve që përmbajnë certifikata për qasje në sistem Depo-x, për klientët shfrytëzues të sistemit në fjalë, kryesisht ndaj bankave komerciale dhe të ngjashme.

26. Shpenzimet e personelit

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|--|------------------------|------------------------|
| Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve | 2,843,576.04 | 2,782,448.61 |
| Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor | 704,381.23 | 689,857.12 |
| Shpenzimet e trajnimeve | 53,956.93 | 82,816.72 |
| Shpenzimet për Bordin e BQK-së | 101,716.90 | 74,199.37 |
| Shujta ditore | 168,382.50 | 165,088.50 |
| Shpenzime tjera | 18,460.28 | 9,344.69 |
| Gjithsej | 3,890,473.88 | 3,803,755.01 |

Gjithsej numri i të punësuarve që kanë qenë aktivë në listën e pagave gjatë periudhës janar - shtator 2024 është: 230 (në periudhën janar - shtator 2023, 230).

Në kategorinë **tjera të shpenzimet e personelit** përfshihet kompensimi shtesë pensional (2024, 6,792.39 euro; 2023, 6,792.39 euro), mbështetja financiare për strehim (2024, 1,255.41 euro; 2023, 1,512.30 euro) dhe programi i praktikës së studentëve (2024, 10,412.48 euro, 2023, 1,040.00 euro).

Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtorë kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimi ndaj tyre te fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.

27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|--|------------------------|------------------------|
| Shpenzimet e sigurimit | 202,827.74 | 307,499.99 |
| Shpenzimet e operacionit të keshit | 27,787.55 | 25,742.74 |
| Riparime dhe mirëmbajtje | 61,980.70 | 68,121.00 |
| Mirëmbajtje të aplikacioneve | 313,757.07 | 320,206.00 |
| Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti) | 24,720.81 | 24,140.99 |
| Shpenzimet e shërbimeve publike/komunale | 64,715.68 | 65,085.07 |
| Shpenzimet e konsultimeve dhe të auditimit | 12,462.71 | 7,247.34 |
| Shpenzime të sigurimit fizik (të objektit) | 124,417.10 | 84,482.70 |
| Udhëtimet dhe transporti | 92,099.16 | 74,914.57 |
| Shpenzimet operative të automjeteve | 13,762.88 | 16,151.17 |
| Material shpenzues administrativ | 3,474.50 | 5,515.65 |
| Shpenzimet e bufesë (për kafe ndaj personelit dhe takime të ndryshme) | 35,379.52 | 32,292.51 |
| Shpenzime për furnizime (për pajisje me kosto jomateriale) | 6,615.55 | 11,097.09 |
| Publikimet dhe literatura | 16,068.89 | 10,368.00 |
| Shpenzimet e përfaqësimit | 32,967.89 | 25,032.31 |
| Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale | 42,092.54 | 27,547.01 |
| Tjera | 7,961.00 | 4,350.82 |
| Gjithsej | 1,083,091.29 | 1,109,794.96 |

Ndryshimet të shpenzimet e përgjithshme administrative janë rrjedhë e aktiviteteve dhe vendimeve operative, si dhe pjesërisht nga ndonjë aktivitet që nuk ka pasur periodicitet të njëjtë në periudhat krahasuese. Duhet theksuar se anëtarësimet në institucione profesionale janë me trend rritës pasi edhe ashtu kemi zgjeruar institucione ku janë bere anëtarësime përkatëse.

28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit

| | 30 Shtator 2024 | 30 Shtator 2023 |
|--|------------------------|------------------------|
| Rivlerësimi valutor | | |
| nga zëri/at në USD | (141,027.24) | (515,992.38) |
| nga zërat në SDR | 75,508.72 | 620,508.76 |
| Neto fitimi/(humbja) e përealizuar (nga ndryshimi i kursit të këmbimit) | (65,518.52) | 104,516.38 |

Rezultati i paraqitur më lart është i përkohshëm (specifikisht vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR dhe EUR/USD.

29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

| | Shënim | 30 Shtator 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|--|---------------|------------------------|------------------------|
| Paraja e gatshme | 5 | 137,100,255.96 | 101,931,866.18 |
| Llogaritë rrjedhëse me bankat jo rezidente | 6 | 354,345,874.85 | 424,842,745.30 |
| Plasmanët në tregun e parasë dhe me maturitet deri në tre muaj | | 467,022,916.22 | 205,280,711.82 |
| Gjithsej | | 958,469,047.03 | 732,055,323.30 |

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të likuiditetit kryesisht afatshkurtër. Një investim kualifikohet si ekuivalent i parasë kur ai ka maturitet afatshkurtër, më pak se tre muaj nga data e blerjes.

30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente**Anëtarësimi në Bankën Botërore**

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjencionet e saj, Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguajë sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre më 30 shtator 2024 është rreth 718,122 euro (më 31 dhjetor 2023 ky detyrim i pritshëm ka qenë 718,218 euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën perkujdesje (garantuese).